



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 255 Akti

Nr. 170 Vendimi
Tiranë, më 26.6.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu

Kryesuese

Alma Faskaj

Relatore

Lulzim Hamitaj

Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 26.6.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Luan Hasneziri**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, (në vijim Kushtetuta);

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim Ligji nr. 86/2016);

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Luan Hasneziri, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit (në vijim ILDKPKI) ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Luan Hasneziri, duke krahasuar: deklaratën e pasurisë “Vetting”; deklaratat e pasurisë në vite; dhe dokumentacionin justifikues bankar, jobankar etj., të dorëzuar nga vetë subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Hasneziri:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për të ardhurat e huadhënësve;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 7.2.2019, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Luan Hasneziri.

5. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 18.1.2019, të trupit gjykues nr. 3, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016 për dy kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë dhe kontrollin e figurës. Me mirëkuptim u caktua kryesues i trupit gjykues, komisionere Suela Zhegu. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

6. Në datën 6.2.2019 subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi përbërjen e trupit gjykues, për të cilin në datën 7.2.2019 deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

7. Në datën 8.5.2019, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Hasneziri, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes për kriterin e pasurisë dhe të figurës.

8. Në datën 13.5.2019 trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendime/sqarime shtesë brenda datës 22.5.2019, për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

9. Në datën 18.5.2019 subjekti i rivlerësimit paraqiti një kërkesë për përfshirjen në procesin e rivlerësimit edhe të kriterit profesional, si dhe për rihapjen e hetimit.

10. Në datën 18.5.2019 subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

11. Në datën 23.5.2019, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, datë.23.5.2019, vendosi mospranimin e kërkesës për rihapjen e hetimit dhe përfshirjen e kriterit të vlerësimit profesional, duke arsyetuar: “... në gjendjen që janë aktet dhe pas parashtrimeve të subjektit nuk jemi para një kërkesë të bazuar për rihapjen e hetimit, duke rezervuar të drejtën që pas shpjegimeve në seancë dëgjimore, trupa të çmobjë përfundimisht rihapjen ose jo të hetimit të çështjes”.

12. Trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Luan Hasneziri, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 27.5.2019, ora 9:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

13. Në datën 24.5.2019 subjekti i rivlerësimit u njoftua për ndryshimin e orarit të seancës dëgjimore për në orën 14:00 të po të njëjtës datë.

14. Në datën 24.5.2019 u zhvillua seanca dëgjimore ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent. Në fillim të seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit paraqiti një kërkesë paraprake për përjashtimin e trupit gjykues.

15. Trupi gjykues, me vendimin nr. 4, datë 27.5.2019, vendosi ndërprerjen e seancës dëgjimore dhe dërgimin e kërkesës për shqyrtim nga një tjetër trup gjykues.

16. Trupi gjykues, i ngritur me vendimin nr. 33, datë 27.5.2019, arsyetoi: “Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ushtron funksionet e tij si institucion i pavarur dhe i paanshëm, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, në përputhje me Kushtetutën, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut si dhe ligjin nr. 84/2016.

Trupi gjykues çmon se për asnjë rast ushtrimi i detyrës funksionale dhe/ose mënyra e interpretimit dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi, nuk përbën paragjykim dhe cenim të paanësisë së trupit gjykues dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përbëjë shkak për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues, si e pa mbështetur në asnjë nga parashikimet e ligjit nr. 84/2016, ligjit nr. 44/2015, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

Parimet e paanësisë dhe objektivitetit në gjykim, të parashikuara në nenet 6 dhe 39 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, nenit 42 të Kushtetutës nuk janë cenuar në këtë rast konkret nga trupi gjykues”.

17. Me vendimin nr. 3947, datë 30.5.2019, trupi gjykues i ngritur për të shqyrtuar kërkesën e subjektit për përjashtim, vendosi rrezimin e kërkesës së subjektit.

18. Në datën 12.6.2019 subjekti i rivlerësimit u njoftua për seancën dëgjimore datë 20.6.2019. Gjatë kësaj seance dëgjimore subjekti paraqiti një kërkesë tjetër paraprake me objekt marrjen e dokumenteve që kanë të bëjnë me vlerësimin etik dhe profesional të Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, z. Luan Hasneziri.

19. Trupi gjykues u tërhoq për shqyrtimin e kësaj kërkesë paraprake dhe me vendimin e datës 20.6.2019 vendosi të mos pranojë kërkesën e z. Luan Hasneziri për t'u njohur me raportin e vlerësimit etik dhe profesional, si dhe për vlerësimin e tij për kriterin profesional. Trupi gjykues çmoi gjithashtu vazhdimin e seancës dëgjimore në po të njëjtën ditë.

II. SEANCA DËGJIMORE

20. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Luan Hasneziri, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jabobs.

21. Gjatë seancës dëgjimore të datës 20.6.2019, subjekti i rivlerësimit, z. Luan Hasneziri, shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

22. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Luan Hasneziri, kërkoi konfirmimin në detyrë.

23. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Hasneziri. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 20.6.2019, për të rifilluar në datën 26.6.2019, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

24. Z. Luan Hasneziri ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur dhe dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

25. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

25.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

25.2 Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i

ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

25.3 Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

25.4 Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

25.5. Por, referuar në vendimin nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e këtij subjekti dërguar në Komisioni; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (dh) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

27. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

28. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 nisi shqyrtimi i deklaratës “Vetting”, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Luan Hasneziri.

29. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

30. Procesi i rivlerësimit nga Komisioni për komponentin e pasurisë është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë “Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë për vitet 2003 – 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

31. Subjekti i rivlerësimit, z. Luan Hasneziri, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë “Vetting” (duke përfshirë personat e lidhur) në datën 27.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja

e tij në fuqi. Në deklaratën e pasurisë “Vetting” të vitit 2017 subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto pasuri dhe likuiditete:

32. Apartament banimi me sip. 135 m², ndodhur në Rr. “**”, Tiranë, me nr. pasurie ****, f. ****, z.k. ****.**

- ✓ Burimi i krijimit: kontrata e huas me nr. ****, datë 4.1.2007, lidhur me shtetasin A. H. dhe kontrata e kredisë bankare e lidhur me “Raiffeisen Bank” me nr. ****, datë 9.1.2007.
- ✓ Vlera: 5.900.000 lekë.
- ✓ Pjesa takuese e subjektit: 100%.

32.1 Faktet që rezultojnë nga hetimi administrativ kryesisht dhe provat e administruara¹

32.1.1 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2006, në të cilën është shprehur: “*Apartament banimi me sipërfaqe 135 m², ndodhur në rr. “****”, pranë njësisë nr. ****, Tiranë (bashkëngjitur një kopje e vërtetimit të pronësisë); vlera 5.900.000 lekë; 100%. Kjo pasuri është bërë në bazë të: 1) kontratës së huas nr. ****, datë 4.1.2007, e lidhur midis meje dhe shtetasit A. H. (bashkëngjitur një kopje e kësaj kontrate); 2) kontratës së kredisë bankare dhe hipoteke nr. ****, datë 9.1.2007, të lidhur midis meje dhe ‘Raiffeisen Bank’ sh.a. (bashkëngjitur një kopje e kësaj kontrate)’*”.

32.1.2 Në bazë të kontratës së shitblerjes nr. ****, datë 12.12.2006, mes palëve shitëse A. P. dhe S. H. (përfaqësuar me prokurë nr. **** kol., datë 11.12.2006, nga gjyqtari A. F.) dhe palës blerëse Luan Hasani, është realizuar kalimi i pronësisë të subjekti i rivlerësimit mbi një apartament me sip. 135m², ndodhur në Tiranë, rruga “****” regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, pasuria nr. ****, z. k. ****, vol****, f. ****, në vlerën 5.900.000 lekë. Kjo vlerë, sipas disponimit në kontratë, është likuiduar jashtë zyrës së noterit.

32.1.3 Nga deklarimi i bërë në DPV-në e vitit 2006 dhe atij në deklaratën “Vetting”, rezulton se subjekti referon si burim të krijimit të kësaj pasurie dy kontrata të lidhura në muajin janar të vitit 2007 (hua nga shtetasi A. H. dhe kredi nga “Raiffeisen Bank”), pra një muaj më vonë se lidhja e kontratës së shitjes së saj. Pra, këto dy burime, sipas deklarimeve, janë përdorur nga subjekti për të likuiduar çmimin e blerjes së kësaj pasurie me një kontratë të lidhur një muaj më parë, konkretisht në dhjetor të vitit 2006.

32.2 Faktet që rezultojnë nga hetimi administrativ kryesisht dhe provat e administruara

32.2.1 Lidhur me saktësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti në deklaratat periodike, në deklaratën “Vetting” dhe deklarimeve të dhëna gjatë procesit të rivlerësimit:

- Komisioni, në analizë të deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit, deklarimit në deklaratën “Vetting” dhe deklarimeve të dhëna gjatë procesit të rivlerësimit, konstatoi se ka mospërputhje për sa i përket burimit të krijimit dhe mënyrës së shlyerjes së çmimit të blerjes së kësaj pasurie, të cilat për sa më sipër u bënë objekt i këtij hetimi.

- Nga hetimi ka rezultuar se në bazë të kontratës së shitblerjes nr. ****, datë 12.12.2006, mes palëve shitëse A. P. dhe S. H. (përfaqësuar me prokurë nr. ****, datë 11.12.2006, nga gjyqtari A. F.), dhe palës blerëse Luan Hasani, është realizuar kalimi i pronësisë të subjektit të rivlerësimit mbi një apartament me sip. 135m², ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, pasuria nr. ****, z.k. ****, vol****, f. ****, në vlerën 5.900.000 lekë. Kjo vlerë, sipas disponimit në kontratë, është likuiduar jashtë zyrës së noterit.

- Subjekti i rivlerësimit, si një nga subjektet përfituese të kredisë së butë, ka përfituar të drejtën për marrje kredie nga “Raiffeisen Bank”. Kjo bankë, me shkresën nr. ****prot., datë 18.3.2019,

¹ Referohuni dokumentacionit të administruar në dosjen e procesit të rivlerësimit.

konfirmon se në bazë të kontratës së datës 16.1.2007, subjekti ka përfituar një kredi në shumën 5.000.000 lekë, me qëllim blerje apartamenti. Në dokumentacionin shoqëruar të kredisë bëjnë pjesë kontrata e shitblerjes së apartamentit dhe kontrata e huas me të vëllanë e subjektit, personin tjetër të lidhur, z. A. H. . Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga banka konstatohet se ky autoritet financiar ka bërë vlerësimin e apartamentit në shumën 11.000.000 lekë, sipas vlerës së tregut në datën 28.12.2006, pra, gati dyfishin e vlerës së kontratës së shitjes së datës 12.12.2006. Gjithashtu, në analizë të plotësimit të kriterëve ligjore nga zyra ligjore e bankës është sugjeruar që të plotësohet dokumentacioni nga aplikuesi me një kontratë huaje që parashikon detyrimin ndaj të tretëve, duke qenë se në kontratën e shitblerjes është parashikuar që çmimi për blerjen e kësaj pasurie është shlyer.

- Në analizë të dokumentacionit bankar të administruar rezulton se në datën 19.1.2007 subjekti i rivlerësimit e ka tërhequr *cash* të gjithë shumën e disbursuar të kredisë. Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton që nga subjekti i rivlerësimit të ketë një transaksion bankar me qëllim pagesën e vlerës së apartamentit apo shlyerje të detyrimeve të tjera të tij kundrejt të tretëve, në kuadër të pagesës për këtë pasuri.

- Nisur nga fakti që në kontratën e shitblerjes së pronës citohej që çmimi është likuiduar tërësisht, shumata e kredisë është *disbursuar* në datën 19.1.2007, trupi gjykues iu drejtua subjektit të rivlerësimit, duke i kërkuar shpjegime për sa më sipër.

32.2.2 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur në lidhje me këtë mospërputhje, ka deklaruar se²: “Në datën 12 dhjetor 2006, unë kam lidhur te noteri kontratën e shitjes së banesës, ku, në momentin e nënshkrimit të kontratës, i kam dorëzuar, në dorë ose *cash*, jashtë zyrës noteriale, përfaqësuesit me prokurë të shitësit, shumën prej 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, të reja. Pas lidhjes së kontratës, në datën 12.12.2006, pas disa ditësh, dhe konkretisht, në datën 21 dhjetor 2006, unë e kam regjistruar këtë banesë në emrin tim dhe certifikatën e pronësisë së banesës e kam dorëzuar te banka ‘Raiffeisen’, në mënyrë që ajo të më lidhte kontratën e kredisë. ... edhe pse unë mora certifikatën e pronësisë së banesës që bleva në emrin tim që në datën 21 dhjetor 2006, dorëzimi i banesës nga përfaqësuesi me prokurë i shitësit z. A. F., është bërë në janar të vitit 2007, vetëm pasi unë i kam shlyer shitësit edhe pjesën tjetër të çmimit të blerjes, prej 4.400.000 (katër milionë e katërqind mijë) lekësh, pasi me shitësin unë kisha rënë dakord që të ma dorëzonte banesën vetëm pasi unë t’i shlyeja, plotësisht çmimin e blerjes së saj.

Por, pavarësisht se unë i kisha të plotësuar të gjitha dokumentet për marrjen e kredisë, banka ‘Raiffeisen’ po më vononte lidhjen e kontratës së kredisë, ndërkohë që kishin kaluar disa ditë nga lidhja e kontratës së shitjes dhe përfaqësuesi me prokurë i shitësit, z. A. F., po më kërkonte, me ngut, pjesën tjetër të çmimit të shitjes. Në këto kushte, më 4 janar 2007, unë i kam marrë vëllait tim A. H., hua shumën prej 5.900.000 (pesë milionë e nëntëqind mijë) lekësh, të reja, i cili më ka dorëzuar në dorë ose *cash*, jashtë zyrës noteriale, për të cilën kemi lidhur edhe një kontratë huaje te noteri, po atë ditë. Nga shumata prej 5.900.000 (pesë milionë e nëntëqind mijë) lekësh, të reja, që i kisha marrë hua vëllait tim A., unë, në ditët e para të janarit 2007, kam likuiduar përfaqësuesin me prokurë të shitësit të banesës z. A. F., duke i dorëzuar shumën prej 4.400.000 (katër milion e katërqind mijë) lekësh, të reja, ndërsa, pjesën tjetër, shumën prej 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, të reja, e kam përdorur për mobilimin e apartamentit....

Ndërkohë, në datën 7 janar 2007, unë kam lidhur kontratën e kredisë me bankën ‘Raiffeisen’, ku unë kam marrë kredi shumën prej 5.000.000 (pesë milionë) lekësh, të reja, nga e cila, shumën prej 4.900.000 (katër milionë e nëntëqind mijë) lekësh të reja, ia kam kthyer vëllait tim A., në dorë ose *cash*, disa ditë pasi kam marrë kredinë nga banka, duke i ngelur borxh atij,

² Referohuni pyetësorit nr. 2 të administruar në Komision me nr. *** prot., datë 6.3.2019.

në janar të vitit 2007, një shumë prej 1.000.000 (një milion) lekësh të reja, shumë të cilën ia kam likuiduar më pas, me këste, deri në fund të vitit 2014”.

32.2.3 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëngjitur këtij deklarami edhe deklaratat noteriale të hartuara pas pyetësorit të dërguar të shtetasve A. F. dhe A. H., të cilët konfirmojnë atë që është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

Duke qenë se z. A. F. ka qenë subjekt i rivlerësimit, Komisioni çmoi se duhet të administrohen dhe të merren në analizë deklaramet e tij gjatë procesit për t'i ballafaquar me deklaramet e dhëna në prokurën e datës 11.12.2006, veprimet dhe mosveprimet e tij si përfaqësues me prokurë i kumatit të tij për shitblerjen e kësaj pasurie dhe mënyra e shlyerjes së vlerës së këtij apartamenti.

32.2.4 Z. A. F., gjatë procesi të tij të rivlerësimit, është shprehur : *“Të nesërmen e largimit të tyre, shtetasi Luan Hasani më ka kontaktuar mua duke më bërë të ditur se kishte siguruar paratë për blerjen e banesës dhe menjëherë pas kësaj, ndërsa isha i pajisur me prokurë nga pronarët e apartamentit A. P. dhe S. H., unë kam lidhur në emër dhe për llogari të tyre kontratën e shitjes nr. ***, datë 12.12.2006. Çmimi i shitjes së banesës prej 5.900.000 lekësh është paguar cash nga ana e blerësit Luan Hasani. Nga kjo shumë, me marrëveshje me kunatin tim A. P., unë kam mbajtur si hua një pjesë të saj, që e konvertuar ka qenë 10.000 euro, kurse pjesën tjetër të çmimit të paguar nga blerësi unë ia kam dorëzuar babait të kumatit tim, njëherazi dhe vjehrrin im, shtetasi P. P. .”*

32.2.5 Subjekt i rivlerësimit, lidhur me marrëdhëniet që ka pasur me z. A. F., parashtroi: *“Kjo kontratë e lidhur ndërmjet nesh, për shkak të njohjes dhe marrëdhënies së besimit, është lidhur në kushte të veçanta, duke pranuar shitësi, i cili ishte përfaqësues me prokurë i kumatit të tij (vëllait të gruas) që të ma shiste banesën në kushte të tilla. Duke qenë se kjo kontratë është lidhur në rrethana të veçanta, ku të dy palët e njihnin dhe kishin besim tek njëri-tjetri, në këtë rast, nuk gjen zbatim rregull ligjor, i parashikuar në nenin 232 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit nuk lejohet prova me dëshmitar kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë. Në këtë rast, për shkak të marrëdhënies të posaçme të palëve, lejohet prova me dëshmitarë, duke u zbatuar germa “ç” e nenit 233 të këtij Kodi që përcakton se lejohet të provohen fakte të caktuara me dëshmitarë, nëse ekzistojnë rrethana ose marrëdhënie të posaçme ndërmjet palëve”.*

32.2.6 Komisioni çmon se në rastin konkret, në tërësinë e fakteve dhe rrethanave të parashtruara, marrëdhënia e subjektit me z. A. F. nuk mund të kategorizohet sipas germës “ç”, të nenit 233, të Kodit të Procedurës Civile, pasi qenia kolegjë nuk mund të konsiderohet as “rrethanë” dhe as “marrëdhënie e veçantë”, në kuptim të këtij neni.

32.2.7 Pavarësisht për sa më sipër, Komisioni në analizë gjithashtu dhe të dy deklaramet të dhëna, çmon se ato janë kontradiktore dhe nuk mund të përbëjnë provë për të provuar vërtetësinë e deklaramet të subjektit lidhur me mënyrën e shlyerjes së vlerës së kësaj pasurie.

32.2.8 Në analizë të deklaramet të dhëna dhe provave të administruara rezulton se subjekti i rivlerësimit ka parashtruar tre alternativa të ndryshme të shlyerjes së vlerës së kësaj pasurie: e para i referohet deklaramet të bëra në kontratë, e cila disponon një shlyerje të plotë të çmimit të pasurisë para lidhjes së saj, pra, jashtë zyrë noteriale; e dyta, duke përdorur huan që ka marrë nga personi tjetër i lidhur, vëllai tij A. H. dhe kontrata e kredisë; si dhe e treta sipas deklaramet që ka bërë gjatë procesit të rivlerësimit, pra, duke shlyer pjesërisht në masën 1.5 milionë lekë me të ardhurat e tij dhe pjesën tjetër me huan e marrë nga personi tjetër i lidhur, vëllai tij A. H., detyrimi i të cilit është shlyer pas marrjes së kredisë së butë.

32.2.9 Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaramet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- i. deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me deklaratën “Vetting” të vitit 2017, me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ZVRPP-ja Tiranë, mbi pronësinë e tij mbi një apartament me sipërfaqe 135 m², ndodhur në Rr. “****”, Tiranë;
- ii. subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të dhëna kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit me deklaratimet e bëra në deklaratën periodike të vitit 2006, si dhe në deklaratën “Vetting”;
- iii. subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën periodike të vitit 2006 dhe në deklaratën “Vetting”, duke deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie të ardhura të krijuara pas datës së lidhjes së kontratës së shitjes.

32.3 Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit

32.3.1 Komisioni, duke marrë në konsideratë dhe duke analizuar deklaratimet periodike të subjektit të rivlerësimit, deklaratën “Vetting” dhe deklaratimet gjatë procesit të vlerësimit, çmoi se për të analizuar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie duhet të shprehë së pari qëndrimin lidhur me kohën dhe mënyrën e likuidimit të vlerës së kësaj pasurie

32.3.2 Për të përcaktuar në mënyrë të drejtë se cila është koha dhe mënyra e shlyerjes së vlerës së apartamentit, Komisioni çmon se në tërësinë e provave, kontrata e shitjes, e cila është lidhur midis subjektit dhe shitësit përcakton në mënyrë të qartë mënyrën e likuidimit të vlerës, pikërisht jashtë zyrës noteriale, para lidhjes së kontratës.

32.3.3 Në bazë të nenit 660 të Kodit Civil ku parashikohet: “...palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”, i lidhur ky dhe me nenin 690 të po këtij kodi: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët”, Komisioni çmon se parashikimet e bëra në këtë akt janë të detyrueshme.

32.3.4 Subjekti në deklaratimet e tij ka synuar që të kundërshtojë disponimet e bëra në kontratë, duke na vënë në dispozicion deklarata noteriale të bëra gjatë procesit të rivlerësimit, që tregojnë se likuidimi i vlerës së apartamentit nuk ka qenë sipas parashikimeve të dhëna në kontratë. Deklarimet e subjektit tregojnë gjithashtu se mënyra e likuidimit nuk është në përputhje as me deklaratimet e bëra në deklaratat periodike dhe as në deklaratën “Vetting”.

32.3.5 Duke bërë një analizë të burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, bazuar në kontratën e shitjes komisioni çmon se subjekti nuk ka patur burime të ligjshme të të ardhurave për të krijuar pasurinë e analizuar në vitin 2006 dhe për të bërë shpenzime duke rezultuar një bilanc negative në vlerën - 4,786,638. Në vijim analiza financiare e vitit 2006;

| Përshkrimi | 2006 |
|---|-----------|
| Pasuri | 5,900,000 |
| Apartament banimi me sip.135 m ² , Rr. “****” | 5,900,000 |
| Të ardhurat | 1,072,733 |
| Të ardhura nga paga subjekti ³ | 1,072,733 |
| Shpenzime | 397,114 |
| Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së | 219,114 |
| Shpenzime qiraje gjatë punësimit në qytetin e Vlorës | 60,000 |
| Shpenzime për pagesën e taksës së kalimit të pronës apartament, 2% ⁴ | 118,000 |
| Likuiditete në fillim të periudhës | 601,464 |

³ Shihni në dosjen e ILDKPKI-së vërtetimin nr. *** prot., në datën 25.1.2017, nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

⁴ Konstatuar gjatë hetimit administrative që kjo taksë është paguar nga subjekti, si dhe e konfirmuar prej tij në përgjigje të pyetësorit Nr. 3.

| | |
|--|--------------------|
| Llogari rrjedhëse e subjektit në “Raiffeisen Bank” | 51,464 |
| Kursime <i>cash</i> | 550,000 |
| Likuiditete në fund të periudhës | 163,721 |
| Llogari rrjedhëse e subjektit në “Raiffeisen Bank” | 163,721 |
| Kursime <i>cash</i> | 0 |
| Të ardhura - pasuri - shpenzime + likuiditete në fillim të periudhës - likuiditete në fund të periudhës | - 4,786,638 |

32.3.6 Komisioni, për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga analiza financiare, arrin në konkluzionin se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme të të ardhurave për të krijuar pasurinë e analizuar në vitin 2006 dhe për të bërë shpenzimet, duke rezultuar me një bilanc negative në vlerën 4.786.638 lekë.

32.3.7 Komisioni, në analizë të burimeve të ligjshme të deklaruara për këtë pasuri, çmoi se vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. A. H., në bazë të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, ka statusin e personit tjetër të lidhur. Për këtë arsye nga Komisioni u krye një hetim administrativ lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të vlerës prej 60 milionë lekë, në janar të vitit 2007, të cilat ky i fundit i deklaroi se ia ka dhënë vëllait të tij, duke i kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacionin për këtë, si dhe duke iu drejtuar, gjithashtu, autoriteteve kompetente⁵.

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucionet dhe nga subjektet bankare rezulton se z. A. H. është anëtar i familjes bujqësore me kryefamiljar, z. T. H. .

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ZVRPP-ja Kurbin rezulton se z. T. H. ka përfituar tokë në bazë të ligjit nr. 7501, datë 1.7.1991 “Për tokën”, në bazë të dy akteve të marrjes së tokës në pronësi (formular 7): AMTP nr. ***, datë 19.9.1993 dhe AMTP nr. ***, të vitit 1993. Në bazë të AMTP nr. ***/1993, z. T. I. H., ka përfituar sip. 3.750 m² tokë, nga të cilat 3.500 m² arë, 150 m² pemëtoare dhe 100 m² truall. Në bazë të AMTP nr. ***/1993, z. T. I. H., ka përfituar sip. 6.695 m² arë, nga të cilat i është regjistruar në ZVRPP-në Kurbin sip. 6.684 m². Pasuritë sipas akteve të mësipërme ndodhen në fshatin G., M. .

- Nga përgjigjia dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ALUIZNI Lezhë, rezulton se z. A. H. ka nënshkruar Formularin e Vetëdeklarimit për legalizim të një objekti pa leje të datës 2.8.2006, me sip. (në bazë) 110 m², të ndërtuar në vitin 1998 në lagjen “*****”, M. . Më tej, në bazë të deklaratës së përfshirjes në procedurat e legalizimit të datës 22.12.2014, ka deklaruar se ndërtimin në fjalë e ka realizuar në vitin 2002. Objekti është me tre kate (pra, sipërfaqja totale duhet të jetë 300 m²).

- Nga hetimi rezultoi se nuk ka të dhëna për gjendje kursimesh në banka në emër të shtetasit A. H. . Po kështu, për sa i takon periudhës së verifikimit (2006 – 2007) nuk rezultojnë pasuri të tjera të luajtshme apo të paluajtshme në emër të tij.

- Në pyetësorin 2, Komisioni i kërkoj subjektit të rivlerësimit që të deklarojë burimin e të ardhurave të vëllait të tij, si dhe të mbështesë deklarin me dokumentacion provues. Nga analiza e përgjigjeve të dërguara dhe dokumentacionit rezultoi se për periudhën 1995 – 2001, subjekti i rivlerësimit nuk disponon dokumentacion provues as për punën dhe as për të ardhurat e të vëllait, për periudhën 2001 – 2006. Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit fotokopje të pasaportës së shtetasit A. H. dhe dy deklarata nga dy shtetas grekë Th. M. dhe I. K. . Nuk rezulton dokumentacion nga organet fiskale greke që provon të ardhurat

⁵ Lutemi gjeni përgjigjet e ardhura në dosjen e procesit të rivlerësimit.

neto dhe as dokumentacion që provon nëse pagesat e deklaruara janë *neto* apo *bruto*, si dhe as për mënyrën e kryerjes se pagesës mujore.

32.3.8 Për sa më sipër pavarësisht se Komisioni arriti në konkluzionin se kjo hua nuk mund të jetë burim i krijimit të saj për sa është arsyetuar më sipër, Komisioni çmon se edhe sikur kjo hua të ishte burim, subjekti nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vëllait të tij, z. A. H. .

32.3.9 Me qëllim për të krijuar një panoramë sa më të plotë, duke marrë gjithashtu në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, pa vënë në diskutim konkluzionin e arritur më sipër, Komisioni çmoi se duhet të bënte një analizë financiare të vitit 2006 në të cilën subjekti ka shlyer vetëm vlerën prej 1.5 milionë lekë në muajin dhjetor të vitit 2006.

32.3.10 Në përfundim Komisioni çmon se subjekti përsëri nuk ka pasur burime të ligjshme të të ardhurave për të krijuar pasurinë e analizuar në vitin 2006 dhe për të bërë shpenzime duke rezultuar një bilanc negative në vlerën 386.638 lekë.

32.3.11 Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- i. subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme të të ardhurave për të krijuar pasurinë e analizuar në vitin 2006 dhe për të bërë shpenzime duke rezultuar një bilanc negative në vlerën 4.786.638 lekë.
- ii. subjekti nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur, vëllait të tij, z. A. H. .

33. Automjet tip “Benz 270”, viti i prodhimit 2003, me targa ***

- ✓ Subjekti deklaron se automjeti është në pronësi të shtetasit B. H., por përdoret prej tij në bazë të prokurës së posaçme nr. ***, datë 2.2.2016.
- ✓ Burimi i financimit të kësaj pasurie nga personi tjetër i lidhur, shtetasi B. H., është nga të ardhurat e realizuar nga shfrytëzimi i tokës bujqësore me sip. 9.000 m², ndodhur në M., Kurbin, tokë që është në përdorim të tij, si dhe të ardhurat e realizuara nga puna si emigrant, nga janari i vitit 2012 e në vijim në Greqi.
- ✓ Vlera: 300.000 lekë.

33.1 Faktet që rezultojnë nga hetimi administrativ kryesisht dhe provat e administruara⁶

33.1.1 Shtetasi B. H. i datëlindjes 1983, me banim në M., Kurbin, ka në pronësi automjetin me targa ***, tip “Mercedes Benz” me nr. shasie ***; pronësinë e vërteton me lejen e qarkullimit nr. ***, datë 2.2.2016, dhe certifikatën e pronësisë me nr. ***, datë 2.2.2016, lëshuar nga DRSHTRR-ja Laç, blerë nga vëllai i subjektit, z. A. H. . Ky i fundit e ka blerë këtë automjet në datën 29.2.2012, nga importuesi i saj, z. B. M., kundrejt çmimit 5.000 euro.

33.1.2 Në prokurë shtetasi B. H. deklaron se i jepet leje shtetasit Luan T. Hasneziri që në mungesën, emrin e llogarinë time dhe sikur të isha vet prezent ka të drejtë të paraqitet në DRSHTRR kompetente dhe të kryejë të gjitha veprimet e duhura që shërbejnë për disponimin e këtij mjeti. Të përdorë këtë automjet si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Shqipërisë pa afat të caktuar.

33.1.3 Konstatohet se në të njëjtën datë dhe tek i njëjti noter ku është nënshkruar kontrata e shitjes, z. B. R. H., ka nënshkruar edhe prokurën e posaçme nr. ***, datë 2.2.2016, nëpërmjet të cilës e lë automjetin në posedim të subjektit të rivlerësimit.

⁶ Referohuni dosjes se procesit të rivlerësimit

33.1.4 Të dyja aktet e mësipërme, nga pikëpamja formale dhe përmbajtjesore janë të rregullta dhe të ligjshme. Nga dinamika e veprimeve rezulton se në datën 2.2.2016, fillimisht është nënshkruar kontrata e shitblerjes nr. ***. Më pas, po atë ditë, blerësi ka vijuar me regjistrimin e kontratës dhe paraqitjen e automjetit për kontroll fizik në DRSHTRR-në Kurbin (Laç); kjo e fundit po këtë ditë ka kryer procedurat e kontrollit dhe ka regjistruar mjetin në pronësi të blerësit, duke e pajisur këtë të fundit me certifikatë pronësie dhe me leje qarkullimi. Pas kësaj, pronari i ri i automjetit ka shkuar tek i njëjti noter për të nënshkruar prokurën e posaçme nr. ***.

33.1.5 Mbi të drejtën e përdorimit për këtë pasuri të luajtshme subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurive dhe interesave periodike të vitit 2016, por për herë të parë kjo pasuri në përdorim deklarohet në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

33.1.6 Ndërkohë, nga të dhënat e sistemit të AMF-së, rezulton se emri i subjektit dhe i bashkëshortes rezultojnë me TPL-në që në vitin 2013, periudhë në të cilën automjeti ishte në pronësi të vëllait të subjektit, shtetasit A. H. .

33.1.7 Në lidhje me këtë situatë, në PyetëSORIN 2, Komisioni kërkoi nga subjekti i rivlerësimit që të deklarojë marrëdhënien e posaçme të tij me shtetasin B. R. H., si dhe rrethanat mbi të cilat zotëron automjetin, me apo pa shpërblim.

33.1.8 Subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“... që unë e kam marrë në përdorim nga kushëriri im B., e kam përdorur, jo vetëm për nevojat e mia, por edhe për çdo nevojë që ka patur familja e B., gruaja dhe dy fëmijët e mitur, veçanërisht gjatë fundjavave, ku, unë shkoj, rregullisht tek prindërit e mi në M. dhe ku, banesa dhe familja e kushëririt tim B. është fqinje, vetëm disa metra larg banesës së prindërve të mi....”*. Në vijim subjekti sqaron se: *“.....për vitet 2013, 2014 dhe 2015, unë nuk e kam përdorur, rregullisht këtë mjet dhe nuk kisha si të deklaroja përdorimin e tij, kur në fakt unë mund ta kem përdorur atë, për të tre këto vite, gjithsej, tre ose katër herë. Ndërsa, mosdeklarimi i përdorimit të këtij mjete në deklaratën periodike të vitit 2016, siç e sqarova më lart, nuk është bërë nga ana ime, sepse, përdorimin e tij unë tashmë, sapo e kisha deklaruar në deklaratën “Vetting” të dorëzuar në janar 2017, e cila dorëzohet dhe kontrollohet nga ILDKPI dhe do të ishte përsëritje e padobishme që, të njëjtën gjë ta deklaroja, pas dy muajve, në deklaratën periodike të vitit 2016, e cila dorëzohet po në ILDKPI”*.

33.1.9 Në bazë të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, z. B. H. ka marrë statusin e personit tjetër të lidhur. Në analizë të provave të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, si dhe hetimit të realizuar nga Komisioni konstatohet se në emër të personit tjetër të lidhur, z. B. H., nuk rezultojnë as pasuri të paluajtshme dhe as likuiditete në bankat e nivelit të dytë, si dhe nga DPSHTRR-ja nuk rezultojnë automjete të tjera në pronësi të shtetasit B. H.. Personi tjetër i lidhur, z. B. H., nuk rezulton as i punësuar në vendin tonë. Nga subjekti na është vënë në dispozicion një kopje e pasaportës që tregon se ai ka qëndruar për periudha tre mujore në shtetin grek, si dhe vërtetim të një punëdhënësi në Greqi, pa provuar kështu me dokumentacion ligjor se sa kanë qenë të ardhurat e ligjshme nga kjo veprimtari.

33.1.10 Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- i. deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 përpunet me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DPSHTRR-ja, mbi pronësinë e z. B. H., të automjetit me targa ***;
- ii. subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, pasi nuk rezulton që ta ketë deklaruar këtë interes privat në deklaratat e interesave private periodike/vjetore të viteve 2013, 2014, 2015 dhe 2016, sipas germës “a”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë

10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”;

- iii. subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur shtetasit B. H., për blerjen e këtij automjeti nga personi tjetër i lidhur, z. A. H. .

34. Likuiditete gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, në vlerë 600.000 lekë

- ✓ Burimi i krijimit: kursime nga paga si gjyqtar dhe si pedagog i jashtëm në “***”, Tiranë.
- ✓ Nuk deklaroi pjesën që zotëron.

34.1 Faktet që rezultojnë nga hetimi administrativ kryesisht dhe provat e administruara⁷

34.1.1 Komisioni, duke marrë në konsideratë deklarimin e bërë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” dhe deklarimet që subjekti kishte bërë në deklaratat periodike vjetore hetoi në dy drejtime, së pari në drejtim të saktësisë së deklarimeve *cash* në vite dhe në deklaratën “Vetting”, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre likuiditeteve të deklaruara.

34.2 Lidhur me saktësinë e deklarimeve të gjendjes së likuiditeve *cash*

34.2.1 Subjekti deklaroi për herë të parë gjendjen e likuiditeteve *cash* në vitin 2005, duke saktësuar në deklarimin e këtij viti se kjo gjendje e ka burimin në likuiditetet në vitet 2003 dhe 2004.

34.2.2 Komisioni në analizë të deklarimeve periodike vlerësoi si një hap hetimor të rëndësishëm dhënien e shpjegimeve të subjektit lidhur me deklarimet që ai kishte bërë për likuiditetin *cash*.

34.2.3 Subjekti i pyetur lidhur me likuiditetet *cash* deklaroi se: *“Ashtu si edhe kam sqaruar në shpjegimet e mia në pyetësorët e dërguar nga Ju, si dhe ashtu siç është pranuar edhe nga vetë Ju, deklarimet e mia për kursimet ndër vite, në deklaratat periodike, kanë lapsuse financiare, si dhe gabime të tjera që kanë ardhur si pasojë e moskuptimit të drejtë të deklaratës periodike. Vlerësoj që është jo logjike dhe e arsyeshme që, nga ana Juaj të mos merren parasysh këtë gabime njerëzore dhe lapsuese financiare, të bëra nga unë në deklaratat periodike, për kursimet e mia ndër vite dhe, të konsiderohen sikur ato nuk ekzistojnë, duke arritur në një përfundim që nuk përputhet aspak me realitetin.*

Duke qenë se, deklarimet e mia në deklaratat periodike për kursimet e mia ndër vite, janë rrjedhojë e lapsuseve të mia, si dhe në disa raste i moskuptimit të këtyre deklaratave, vlerësoj që, si kursime të mia ndër vite, duhet të llogariten shumat që unë kam deklaruar në Pyetësorët e dërguara nga ana Juaj, konkretisht në Pyetësorin nr. 3, pasi kjo është gjendja e vërtetë e këtyre kursimeve ndër vite, e cila përputhet plotësisht, ashtu siç e kam sqaruar në shpjegimet e mia të mëparshme, me gjendjen e kursimeve prej 600.000 lekësh, në fund të vitit 2016, të deklaruar nga unë në Deklaratën e Vettingut në janar të vitit 2017”.

34.2.4 Duke marrë në konsideratë deklarimet e bëra në deklaratat periodike vjetore, në deklaratën “Vetting” dhe në deklarimet që subjekti ka bërë gjatë procesit të rivlerësimit u hartua një tabelë, e cila jep një panoramë të qartë të asaj çfarë subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike dhe asaj që ka deklaruar gjatë procesit të rivlerësimit.

⁷ Referohuni dosjes së ILDKPKI-së për subjektin e rivlerësuar.

| Vitet | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | Vetting |
|--|---------|---------|-----------|---------|---------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|---------|
| CASH sipas përgjigjeve të pyetësorit të dytë (shitesat) | 300,000 | 400,000 | 400,000 | 400,000 | 250,000 | 250,000 | 100,000 | 100,000 | 150,000 | 200,000 | 200,000 | 150,000 | 250,000 | - | 600,000 |
| CASH sipas përgjigjeve të pyetësorit të dytë (gjendja në fund të vitit) | 300,000 | 700,000 | 1,100,000 | - | 50,000 | 300,000 | 400,000 | 500,000 | 650,000 | 850,000 | 1,050,000 | 600,000 | 850,000 | 850,000 | |
| CASH sipas deklaratave periodike ndër vite (shitesat) | | | 550,000 | 0 | 220,000 | 1,500,000 | 180,000 | 240,000 | 290,000 | 160,000 | 190,000 | 200,000 | 250,000 | 100,000 | |
| CASH sipas deklaratave periodike ndër vite (gjendja në fund të vitit) | | | 550,000 | 0 | 220,000 | 1,720,000 | 1,900,000 | 2,140,000 | 2,430,000 | 2,590,000 | 2,780,000 | 2,980,000 | 3,230,000 | 3,330,000 | 600,000 |
| CASH sipas përgjigjeve të pyetësorit të tretë (shitesat) | 300,000 | 400,000 | 400,000 | 550,000 | 250,000 | 250,000 | 100,000 | 100,000 | 150,000 | 200,000 | 200,000 | 150,000 | 250,000 | - | 600,000 |
| CASH sipas përgjigjeve të pyetësorit të tretë (gjendja në fund të vitit) | 300,000 | 700,000 | 1,100,000 | - | 50,000 | 300,000 | 400,000 | 500,000 | 650,000 | 850,000 | 1,050,000 | 600,000 | 850,000 | 850,000 | |

34.2.5 Komisioni çmon se pas përgjigjeve të pyetësorit të dytë dhe të tretë, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar tërësisht qëndrimin e tij lidhur me kursimet *cash*, subjekti nuk arriti të provojë me dokumente provues gjendjen e kursimeve *cash* në fund të çdo viti. Në vlerësim të Komisionit u morë në konsideratë vetëm deklarimi i bërë në vitin 2008, ku subjekti deklaroi vlerën 1.500.000 lekë dhe që u konsiderua si deklarim i vlerës në monedhën “*lekë të vjetër*”.

34.2.6 Për sa më sipër në cilësinë e provës janë marrë në konsideratë deklarime periodike të bëra nga subjekti në vite. Nisur nga këto deklarime duket se gjendja e kursimeve *cash* të deklaruara prej subjektit të rivlerësimit deri në fund të vitit 2016 në total rezulton të jetë 3.330.000 lekë ndërkohë që në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar kursime jashtë sistemit bankar në shumën 600.000 lekë.

34.2.7 Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- i. subjekti ka kryer deklarim të pasaktë të kursimeve *cash* në deklaratat periodike të vitit 2003 dhe 2004;
- ii. subjekti ka deklaruar në mënyrë të pamjaftueshme kursimet e tij *cash* në deklaratën “Vetting”.

ANALIZA E GJETJEVE

1. Në deklaratën periodike vjetore të viti 2014 subjekti i deklarimit deklaroi një marrëdhënie huaje me z. R. K. . Në bazë të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmoi se z. R. K. duhet të hetohet në statusin e personit tjetër të lidhur.

1.1 Në vijim të dokumentimit të kësaj marrëdhënie nga subjekti është vënë në dispozicion deklarata noteriale nr. ***, datë 22.2.2014, ku personi tjetër i lidhur, z. R. K., deklaroi se në bazë të kontratës së huas nr. ***, datë 16.1.2014, i kam dhënë hua z. Luan Hasnezirit, shumë prej 40.000 USD, pa interes dhe pa afat të përcaktuar, shumë e cila është shlyer plotësisht më datë 21 shkurt 2014.

1.2 Nga përmbajtja e aktit rezulton se qëllimi i dhënies së kësaj huaje është që shtetasi Luan Hasneziri së bashku me bashkëshorten V. H. (mbesa e huadhënësit) z. R. K., të përdorin pasi ta kenë vendosur si garanci në bankë, si garanci për të marrë vizën në Ambasadën Amerikane, si dhe për mjekim të mëtejshëm në SHBA. Në qoftë se nga Ambasada Amerikane, për çfarëdo arsye, u refuzohet dhënia e vizës, huamarrësit Luan dhe V. H. duhet t'ia kthejë menjëherë huadhënësit R. K. të gjithë shumën e parave të marra hua, por, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë, duke filluar ky afat nga dita e refuzimit të marrjes së vizës. Në qoftë se huamarrësit arrijnë të marrin vizën në Ambasadën Amerikane, si dhe shkojnë në SHBA dhe bëjnë ekzaminimet e mjekimit e duhura, duke i shpenzuar paratë e dhëna hua, nga huadhënësi R. K., plotësisht ose pjesërisht, huamarrësi Luan Hasneziri nuk do të ketë një afat të përcaktuar në kthimin e shumës së marrë hua, por, do ta kthejë këtë shumë, me këste, sipas marrëveshjes së arritur me vullnetin e të dy palëve.

1.3 Subjekti ka depozituar një vërtetim, datë 17.10.2016, nga “Alfa Bank”, dega Vlorë, nëpërmjet të cilit vërtetohet se z. R. K. është klient i kësaj banke me llogari në euro duke bashkëngjitur edhe një nxjerrje të llogarisë së “Alfa Bank” për shtetasin R. K. për periudhën 2.11.2012 – 31.12.2013 të llogarisë në euro.

1.4 Komisioni çmon se deklaratimet e bëra nga subjekti lidhur me këtë marrëdhënie huaje janë të mjaftueshme dhe gjithashtu përputhen.

1.5 Në analizë të aktit dhe të faktit rezulton e provuar gjithashtu se ka një përputhje të qëllimit të huas dhe të deklaratimit në kontratën e huas.

1.6 Lidhur me këtë Komisioni hetoi në drejtim të mënyrës së transferimit të huas, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur.

1.7 Gjatë procesit, si dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti deklaroi se personi i lidhur shtetasi R. K. e ka siguruar shumën prej 40.000 USD nga puna e tij si emigrant në Greqi, si dhe nga aktiviteti i biznesit që figuron në emër të tij, ku si rezultat i punës së tij dhe aktivitetit të biznesit të tij, shtetasi R. K., në periudhën janar 2012 - dhjetor 2013, ka pasur të depozituara në dy numra llogarie, në “Alpha Bank”, dega Vlorë shuma të konsiderueshme parash. Për këtë subjekti i ka bashkëlidhur parashtrimeve këto dokumente: vërtetim i kohës së sigurimit i datës 3.4.2019, lëshuar nga bashkia Ilidas, për derdhjen e sigurimeve shoqërore për periudhën 1.1.1999 – 31.12.1011; dokumentet për pagimin e taksave së të ardhurave nga z. R. K. për vitin 2010; dokumentet për pagimin e taksave së të ardhurave nga z. R. K. për vitin 2011; dokumentet për pagimin e taksave së të ardhurave nga z. Remzi Kapaj për vitin 2012; dokumentet për pagimin e taksave së të ardhurave nga z. R. K. për vitin 2014.

1.8 Subjekti shpjegon se: *“... të gjitha këto prova vlerësoj që, përbëjnë indice të plota, të sakta dhe të rëndësishme që provojnë, plotësisht që shtetasi R. K. të ardhurat që më ka dhënë hua mua në shkurt të vitit 2014 i ka siguruar nga puna e tij në Greqi dhe edhe në këto rast duhet të gjej zbatim pika 2, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2006, cila parashikon që, nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit pamundësinë e marrjes së tij, në rrugë tjetër. Në rastin konkret, unë e kam të pamundur nga pikëpamja objektive që të sjellë çdo dokument që të provojë që, z. R. K., ka paguar tatimet për shumën prej 40.000 USD që më ka dhënë mua hua, për faktin se, këto dokumente ndodhen në një shtet tjetër, si dhe nisur nga fakti që, edhe nga Ju është pranuar që ky shtetas i ka patur këto të ardhura në “Alfa Bank”, dhe, me provat që unë kam arritur që të paraqes së bashku me këto parashtrime, provohet, tej çdo dyshimi të arsyeshëm që të ardhurat e këtij shtetasi kanë ardhur nga puna e tij në Greqi...”*

1.9 Nga dokumentacioni i depozituar gjatë hetimit administrativ⁸ rezulton se të ardhurat për personin tjetër të lidhur për të cilat janë paguar tatime, gjatë kohës që ka qenë i punësuar në shtetin grek, rezulton të jenë deri në vitin 2014 në total në shumën 13.621 euro, të ardhura të cilat sipas viteve respektive rezultojnë të kenë qenë, në vitin 2010 – 4.000 euro, në vitin 2011- 3.531 euro, në vitin 2012 – 4.000 euro, dhe në vitin 2014 në shumën 2.090 euro.

1.10 Komisioni në analizë të tërësisë së provave çmoi se subjekti nuk arriti të provojë mënyrën e transferimit të huas, pasi nuk rezultoi asnjë transaksion bankar nga personi tjetër i lidhur, kalim në llogarinë e subjektit nga personi tjetër i lidhur dhe as kthim nëpërmjet bankës i vlerës së marrë hua.

1.11 Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të ardhurave, referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁹, në kushtet e pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, duhet të plotësohen këto kushte në mënyrë kumulative:

- *të provojnë me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve tatimore për to;*
- *duhet provuar mënyra se si ato kanë mbërritur te subjekti i rivlerësimit;*
- *dërgesat mund të merren në konsideratë në gjykim nëse ka prova të mjaftueshme, të cilat plotësojnë dy kushtet e sipërcituara.*

1.12.Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- i. subjekti ka kryer deklaram të saktë lidhur me detyrimin si në deklaratën periodike dhe në deklaratën “Vetting” të marrëdhënies së huas me personin tjetër të lidhur, z. R. K.;
- ii. subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave dhe transferimin e tyre te subjekti i rivlerësimit.
- iii. analiza e burimit të ligjshëm për personin tjetër të lidhur nuk ka efekt në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, pasi huaja e deklaruar nuk është përdorur prej tij si burim për blerje pasurie, në kuptim të nenit D, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

2. Gjatë hetimit rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar adresa të ndryshme në vite dhe konkretisht: në deklaratën periodike të vitit 2004 kishte deklaruar si adresë banimi Njësia Administrative Nr. 7, “*** Nr. ***”; në deklaratën periodike të vitit 2005 kishte deklaruar si adresë banimi Rr. “***” Nr. ***, Ap. ***; dhe në deklaratën periodike të vitit 2006 kishte deklaruar si adresë banimi Njësia Nr. ***, “Rr***”, pranë ***, Tiranë.

2.1 Subjektit gjatë hetimit iu kërkuan shpjegime rreth deklaratimeve të bëra për adresa të ndryshme përgjatë deklaratimeve në vite.

2.2 Në shpjegimet e tij subjekti ka deklaruar¹⁰: “*Dua të theksoj që shënimi nga ana ime në deklaratat periodike të pasurisë në ILDKPKI të adresave të ndryshme, për vitet 2004, 2005 dhe 2006, mund të jetë bërë nisur nga fakti që, këto deklarata, në rubrikat e tyre kërkonin adresën zyrtarë të subjektit deklarues, me të cilën unë nënkuptoj adresën ku unë kam pasur gjendjen civile, në atë kohë dhe jo adresën konkrete të banimit, e cila, duke qenë se unë kam qenë me qira ka ndryshuar në kohë*”.

2.3 Në vijim subjekti parashtron se: “*.....këto adresa janë deklaruar nga ana ime, në deklaratimet periodike në ILDKPKI në mënyrë ta pamenduar dhe nga pakujdesia dhe, Ju keni*

⁸ Shiko deklaratat e të ardhurave të shtetasin R. K., për punësimin e tij në shtetin grek për vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2014 depozituara nga subjekti i rivlerësimit të administruara në dosjen e procesit të rivlerësimit

⁹ Shih vendimin nr.12, Datë 31.7.2018 Datë 17.12.2018 të kolegjit të posaçëm të apelimit

¹⁰ Lutem referohuni pyetesorit nr.2 te administruar në dosjen e procesit të rivlerësimit

shumë të drejtë që më pyesni, për shpenzimet e mia të banimit për këto adresa, përderisa unë i kam shkruar këto adresa, me dorën time. Por, dua të deklaroj se unë nuk kam banuar asnjëherë në këto katër adresa, fakt ky që rezulton shumë qartë, me adresat e tjera ku, unë kam banuar, për periudhën nga tetori i vitit 2000, deri sot, ku, nga tetori i vitit 2000, deri në tetor të vitit 2005..”

2.4 Komisioni hetoi në lidhje me këtë konstatim dhe çmoi se nuk rezultoi e provuar që subjekti të kishte lidhje me adresat e deklaruara në deklaratën periodike të viteve 2004 dhe 2006. Por, Komisioni çmon se pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet në vite çmohen si një element që cenon etikën e subjektit, por jo e asaj shkalle për të qenë një nga shkaqet ku është bazuar vendimi i shkarkimit.

2.5 Në konkluzion për vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues, arrin në përfundimin se:

- i. subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova, të cilat të provojnë burimin e ligjshëm dhe realizimin e të ardhurave për krijimin e pasurisë apartament, në kuptim të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe, rrjedhimisht, subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë;
- ii. subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme të të ardhurave për të krijuar pasurinë e analizuar në vitin 2006 dhe për të bërë shpenzime duke rezultuar një bilanc negative në vlerën 4.786.638 lekë;
- iii. subjekti, në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të kursimeve *cash* në deklaratat periodike të viteve 2003 dhe 2004, si dhe në deklaratën “Vetting”;
- iv. subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, pasi nuk ka deklaruar të drejtën reale të përdorimit të automjetit në pronësi të z. B. H. në deklaratat e interesave private periodike/vjetore të viteve 2013, 2014, 2015 dhe 2016, sipas germës “a”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”;
- v. subjekti rivlerësimit, z. Luan Hasneziri, nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur sipas parashikimeve të paragrafit 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës;
- vi. subjekti rivlerësimit, z. Luan Hasneziri, nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar me nr. ***, datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 9.2.2019, të KDZH-së, duke konkluduar mbi “*Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Luan Hazneziri.*”

Në raport analizohet: “*Bazuar në kërkesën e pikës 3, të nenit 36, të ligjit nr. 84/2016, me anë të një kërkesë Grupi i Punës nëpërmjet DSIK-së , është informuar se në datën 19.2.2014, subjektit të rivlerësimit, z. Luan T. Hazneziri, i është refuzuar viza amerikane, gjë që nuk është pasqyruar në deklaratën për kontrollin e figurës. Këtu theksojmë faktin që deklarata për kontrollin e figurës është plotësuar nga subjekti i rivlerësimit në datën 25.1.2017, ndërsa refuzimi i vizës është në datën 19.2.2014, gjë që tregon se subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni të këtij fakti dhe duhet ta deklaronte atë”.*

DSIK-ja, në raportin e saj konstaton se për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Hasneziri, formulari është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar dhe bazuar në pikën 2, të nenit 36 të ligjit nr. 84/2016 subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në plotësimin e deklaratës, konkretisht në pikën “g”, të tij *“të dhëna për sigurinë”*, **duke mos deklaruar refuzimin e vizës amerikane**. Mosdeklarimi në këtë rast e ngarkon me **përgjegjësinë e fshehjes së një fakti, të plotësimit të pasaktë dhe me vërtetësi të deklaratës së kontrollit të figurës**.

Komisioni, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me këtë raport subjekti i rivlerësimit shpjegon se: *“Kjo mosdhënie ose refuzim i dhënies së vizës mjekësore për mua në vitin 2014 nga ambasada e SHBA-së nuk është deklaruar nga ana ime si fakt në deklaratën e kontrollit të figurës, sepse ky ka qenë një fakt që nuk përfshihej në të dhënat që duhet të deklaroheshin në këtë deklaratë....*

Në pjesën 5 të kësaj deklarate ka një pyetje e cila shprehimisht ka këtë përmbajtje:

‘Gjatë dhjetë viteve të fundit, a ju është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s?’.

Siç rezulton nga përmbajtja e kësaj pyetjeje shprehimisht kërkohet informacion për “refuzim të hyrjes” dhe jo për “refuzim të dhënies së vizës”, në ndonjë shtet të BE/NATO-s. Vlen të sqarohet fakti që refuzimi i dhënies së vizës dhe refuzimi i vizës janë koncepte të ndryshme. Refuzimi i dhënies së vizës ose mosdhënia e vizës nënkupton mospajisjen me vizë të aplikantit nga ambasada e SHBA-së, për arsye që janë në diskrecion të nëpunësit konsullor dhe që nuk kanë të bëjnë me sigurinë e personit apo me problemet e ligjit që ai mund të ketë..

Refuzimi i vizës nga ambasada e SHBA-së nënkupton që personi është pajisur më parë me vizë nga kjo ambasadë dhe për arsye që kanë të bëjnë me sigurinë e personit ose për shkak se ai ka probleme me ligjin ose sepse nuk ka respektuar kushtet e vizës, kjo vizë i hiqet ose i refuzohet këtij personi..”.

Gjatë hetimit të çështjes Komisionit i rezultoi e provuar si nga deklarata periodike e vitit 2014 dhe nga deklarata e pasurisë “Vetting”, se subjektit të rivlerësimit i është refuzuar viza nga Ambasada Amerikane në datën 19.2.2014, për të cilën ai ka deklaruar dhe një marrëdhënie huaje me personin tjetër të lidhur, z. R. K.¹¹. Subjekti, si në deklaratën periodike të vitit 2014 dhe në deklaratën “Vetting”, nuk e ka fshehur, por në mënyrë të detajuar ka arsyetuar shkakun e marrjes së huas dhe ecurinë e procedurës së tij për marrjen e vizës.

Komisioni çmon se ky deklarim është sigurisht i mirëqenë dhe relevant për komponentin e vlerësimit të pasurisë, por në rastin konkret, në analizë të komponentit të figurës së subjektit, nuk mund të mos merren në konsideratë dhe të vlerësohen edhe këto deklarime në tërësinë e fakteve të administruara. Këto fakte duhet të vlerësohen gjithashtu në raport me detyrimin që ka subjekti i rivlerësimit për ta plotësuar deklaratën e figurës, dhe jo vetëm atë, në mënyrë të saktë, të vërtetë dhe të plotë.

Subjekti i rivlerësimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, ka detyrimin ligjor të plotësojë dhe të dorëzojë personalisht formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, duke e plotësuar atë në mënyrë të saktë dhe në përputhje me parashikimet e pjesës 5, të germës “g”, të shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016.

¹¹ Komisioni ka arsyetuar në Vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit burimin e ligjshëm të personit tjetër të lidhur z. R. K. .

Me nënshkrimin e deklaratës së kontrollit të figurës, prezumohet se subjekti ka qenë i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës, mund të pasjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

Komisioni çmon se në analizën e rastit duhet të pranojë se çfarë ka pasur për qëllim ligjvënësi me parashikimin e bërë në pikën 3, të nenin 61, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me pamjaftueshmërinë e deklaramit në rastin e kontrollit të figurës.

Në vendimin 12 e tij Kolegji i Posaçëm i Apelit arsyeton se pamjaftueshmëria e deklaramit në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të lidhet vetëm me lënien e vendeve bosh në formularin e deklaramit, përkatësisht sipas kriterit, por ka të bëjë me plotësimin e formularit në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, që në momentin e vlerësimit nga grupet e kontrollit të konkludohet në lidhje me përshtatshmërinë ose papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.

Për sa më sipër, pamjaftueshmëria e deklaramit, ashtu si dhe Kolegji arsyeton, nuk lidhet domosdoshmërisht me mosplotësimin fizik të saj, por dhe të faktit se mosdeklarimi e ngarkon subjektin me përgjegjësinë e fshehjes së faktit dhe për rrjedhojë me plotësimin jo me vërtetësi të saj.

Në rastin objekt gjykimi, Komisioni çmon se një element shumë i rëndësishëm që duhet marrë në konsideratë është fshehja, pra, fakti ekziston dhe subjekti e ka fshehur dhe nuk e ka deklaruar dhe, për pasojë, veprimtaria e tij dhe e Komisionit në procesin e rivlerësimit është e cënueshme dhe është penguar nga fshehja e fakteve.

Komisioni, duke e parë *fshehjen* si një element shumë të rëndësishëm, çmon se në procesin e rivlerësimit të këtij subjekti, kur ka vlerësuar komponentin e pasurisë, ka ardhur në dijeni të fakteve, të cilat DSIK-ja i konsideron të fshehura. Këto fakte janë të deklaruara në deklaratën periodike të vitit 2014 dhe në deklaratën “Vetting”.

Komisioni çmon se procesi i rivlerësimit në të tria kriteret nuk mund të jetë një proces i shkëputur nga njëri komponent tek tjetri, dhe aq më tepër nuk mund të jetë një proces që arrin në një konkluzion pas një *fotografimi* të deklaramive të dhëna, në mungesë të konkluzioneve të logjikshme, por vlerësimit “*prima facie*” të deklaramive.

Komisioni, në rastin objekt gjykimi, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk e ka fshehur refuzimin e vizës që i është bërë nga Ambasada Amerikane.

Nga ana tjetër, në rastin konkret Komisioni çmon, gjithashtu, se nuk jemi para faktit të refuzimit të hyrjes në një vend të caktuar, pasi refuzimi i vizës subjektit të rivlerësimit i është bërë sipas seksionit 214 (b) të aktit të SHBA-së¹³. Në këtë akt refuzimi bazuar në këtë nen nuk parashikon shkaqe të tilla si korrupsioni etj, të cituara nga raporti i DSIK-së, por kanë të bëjnë me faktin se aplikanti duhet të tregojë lidhje të forta me vendin e tij dhe nuk ka qëllim ta braktisë. Pikërisht, kjo i është cituar në përgjigje dhe subjektit dhe, konkretisht: “...*ju nuk keni demonstruar se ju keni lidhje, të cilat do t’ju detyrojnë që të ktheheni në vendin tuaj pas udhëtimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës*”. Një shkak tjetër që refuzimi në këtë rast nuk përbën refuzim hyrjeje në SHBA ka të bëjë se nëse subjekti i është refuzuar viza bazuar në seksionin 214 (b) të aktit të SHBA-së, ky i fundit mund riaplikojë përsëri për t’u pajisur me vizë.

Në përfundim të rivlerësimit për kontrollin e kriterit të figurës, trupi gjykues, konkludon se subjekti i rivlerësimit, z. Luan Hazneziri, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera

¹²Shih vendimin nr.2 datë 04.02.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

¹³<https://travel.state.gov/content/travel/en/us-visas/visa-information-resources/visa-denials.html>

nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe ka bërë deklarime të pasakta të cilat nuk janë në nivelin e një shkaku ligjor për shkarkim ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura prej tij, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, mbështetur në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundim se subjekti i rivlerësimit, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar, në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Luan Hazneziri, me funksion prokuror/drejtues pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 26.6.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Suela ZHEGU
Kryesues

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Alma FASKAJ
Relatore